



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ÇËRRIK

Data: 19.04.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “ *Blerje mjet 4x 4 dhe pajisje per zjarrefikese*”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Pajisje zjarrfikëse 35111000-5, automjete

VLERA E FONDIT LIMIT: 9090000 (nente milion e nentedhete mije) **leke pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Cerrik** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjin nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ne te cilen eshte e parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;

b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 te VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 8

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbeshtetje ne nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik“, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, date 19.05.2021 ”Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për

pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kriterëve të vendosura në Kriteret e Përgjithshme për Kualifikim

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021,2022,2023 , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit të vënë në dispozicion.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar Nenin 44, pika 1, paragrafi b), si dhe neni 64 i Ligjit Nr. 9920, datë 19.5.2008 (i ndryshuar) “Per Procedurat Tatimore ne Republikën e Shqipërisë”, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”, si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” etj.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021,2022,2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të neni 41, pika “c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Referuar ligjit nr.25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) neni 29 i tij, ligjit nr. 10 091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar) neni 41 i tij, Vendimit të Këshillit të Ministrave me nr.922, datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike” dhe Udhëzimit nr. 5, datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” (i ndryshuar) pika 3.12 e tij, autoriteti kontraktor gjykon që të kërkojë xhiron vjetore në një vlerë, sa vlera e përlogaritur e fondit limit të marrëveshjes kuadër që prokurohet,

dhe pasqyrat financiare për tre vitet e fundit (2021, 2022, 2023) pasi tatimpaguesit (operatorët ekonomikë) kanë detyrimin që të dorëzojnë në administratën tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës bilancin kontabël së bashku me anekset e tij me kushtin që në dy bilance të njëpasnjëshme të mos kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit, si dhe Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në rastet kur plotësohen kushtet e parashikuara nga ligji.

Njësia e prokurimit përcaktoj kriteret për kapacitetet ekonomike dhe financiare si më lart duke qënë se këto kriteret janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe se i shërbejnë autoritetit tonë kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatoreve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.3 Vertetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2023, sipas përcaktimeve të ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht plotësohet, nga secili anëtar i bashkimit.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 8 të DST. Operatori ekonomik fitues duhet të paraqesë përpara njoftimit të fituesit dokumentacionin vërtetues të vetdeklaruar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, nën 3.1/a, b, c dhe nën 40, në ligjin nr.131/2015 “Për QKB” i ndryshuar, si dhe në ligjin nr.9723 datë 03.05.2007 “Për QKR” i ndryshuar

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjisllacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nën 55, *pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skedat teknike të mallrave objekt prokurimi, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Operatori ekonomik duhet të paraqesë të dhena të plote të mjetit që ofrohen për shitje. Operatori ekonomik duhet të paraqesë kataloget origjinale (ose kopje të noterizuar) perkates në gjuhën shqipe, ku të tregohen karakteristikat teknike të automjetit të ofruar për shitje, (çertifikatë e konformitetit të automjetit) të cilat duhet të përmbushin specifikimet teknike të kerkuara nga autoriteti kontraktor dhe të ofruara nga operatori ekonomik.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar),

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues për produktet objekt prokurimi sipas tabelës në Shtojcën 6, duhet të paraqesë deklaratë furnizimi nga prodhuesi/distributori të autorizuar për mallrat objekt të prokurimit.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 6/b e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar),

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë:

- a) që garanton mbulimin e periudhës së garancisë së paisjeve, për një periudhë jo më pak se 2 vjet;
- b) ku garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin e paisjeve, gjatë periudhës së garancisë;
- c) që garanton mbulimin e periudhës së garancisë së mjeteve, për një periudhë jo më pak se 2 vjet;
- d) ku garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin e automjeteve, gjatë periudhës së garancisë;

Argumentim: Në bazë të pikës 4, neni 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar)

2.3.5 Operatori ekonomik pjesmarrës duhet të paraqesë Çertifikatë **ISO 9001:2015** (e vlefshme) ose ekuivalente të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe bazuar në pikën 1 të nenit 44 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky kriter kerkohet për të patur garancine se malli që do të dorëzohet do të jete brenda standarteve të kerkuara.



II. Argumentimi i specifikimeve teknike




Specifikimet teknike janë përshkruar saktë dhe në mënyrë të plotë duke qenë të paanshme, lidhur me kërkesat e Autoritetit Kontraktor për furnizimin me pajisjet kompjuterike, duke u mbështetur në standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, duke pasur parasysh garancitë përkatëse të këtyre sistemeve, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të V.K.M.-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,

Për sa më sipër, specifikimet teknike nuk kanë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emri të veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ka ekzistuar një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, dhe është cituar fjala “ose ekuivalent” e përfshirë detyrimisht në këto specifikime.

Specifikimet janë hartuar nga specialistet e fushës dhe gjenden bashkengjitur dokumentave standarte të tenderit.




Nr .	Emertimi	Specifikime
1.	Makine 4x4 pick up	Blerje makine zjarrefikese pick up 4x4 Te Pergjithshme Viti i Prodhimit 2023 Gjendja e Re e paperdorur Te dhenat teknike Pick up 4x4. Karburanti Naftë Emetimi i Gazrave Minimum Euro 5 Kambio Manuale, (5 perpara + 1 mbrapa) Motori 4 cilindra Cilindrata Min. 2,800 CC - Maks.3,000 CC Fuqia e motorrit Min. 90 kW -Max.110 kW Sistem Radio CD MP3 Po Sistem A/C Ajer i kondicionuar Po Sistemi i frenimit ABS + EBD Xhamat Komandim elektrik Timoni Hidraulik Distanca midis akseve Min. 3,400 mm - Max. 3,500 mm Numri i akseve 2 Konfigurimi i akseve 4x4 Permasat e gomave 245/70 R17 Gjatesia totale e mjetit Min. 5,600 mm - Max. 5,700 mm Gjeresia totale e mjetit Min.1,850 mm - Max. 1,900 mm Lartesia totale e mjetit Min.1,800 mm - Max. 1,900 mm Lartesia nga toka Min. 210 mm Numri i dyerve te kabines 4 Ndenjese ne kabine 5

			<p>Depozi</p> <p>Presioni i pompës së agregatit me presion të lartë min. 100 bar dhe prurje min. 30 litra/min në100 bar, me rezervuar uji min. 250 litra dhe rezervuari i shkumës prej min. 30 litra, me panel komandimi dhe të gjitha instrumentet dhe treguesit për kontrollin dhe monitorimin e funksionimit të pompës të vendosura në pjesën e pasme të superstrukturës;</p> <p>Depozita e ujit prej çeliku inox;</p> <p>Rezervuari i shkumës prej çeliku inox;</p> <p>Sistemi - komanda për shkumë dozuese-përzierëse 0% - 6%;</p> <p>Pompa me motorr me benzinë</p> <p>Ndezja e motorrit të pompës: startues elektrik dhe tërheqje rezervë me litar.ta e karburantit Min . 75 L</p>
2.	Tuba hedhëse uji profesionalë Ø52 me gjatësi 20ml		<p>Tub gome, STORZ C, pesha 9 kg, gjatësia 20m, ngjyrë e kuqe. Gomë Brenda dhe jashtë, grada e parë.</p> <p>Rezistente ndaj kimikateve, flakëve dhe motit. Nuk ka nevojë të pastrohet e thahet. Presioni i testimit 25 bar, presioni i shpërthimit 50 bar. Të bashkangjitur dhe lidhëset.</p>
3.	Barrelë		<p>Barrelë portative alumini për tu vendosur në mjetin zjarrfikës. Permasat 185.5*52*22.2CM</p>

4.	Tub thithës Ø100, 10 ml		Tub thithës gome 10 ml, me sustë teli dhe lidhëse.
5.	Hedhëse uji profesionale Ø52		STORZ C, pesha 2.1 kg, përbërja alumin+tunxh+materiale të tjera, hedhja e ujit 44m gjatësia e hedhëses 28 cm, rregullatori i rrjedhjes 130, 230, 300, 400 litra në minutë me presion 6 bar.
6.	Pajisje për hapje dhe prerje pneumatike për prerje në rast aksidentesh me të gjithë gjeneratorin (set pajisjesh ne rast aksidentesh)		<p>Prerës hidraulik:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hapja maksimale 20-25 cm. • Pesha 19-25 kg. • Forca e përhapësit 70-80 KN. <p>Zgjerues (hapëse) hidraulike:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hapja e zgjeruesit 70-80 cm. • Forca e zgjerimit 60 KN. • Pesha 20-25 kg. • Forca shtrydhëse 120-130 KN. • Forca tërheqëse 70-80 KN. <p>Piston (shtyrës) hidraulik:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Forca shtytëse (faz1/2) 189 KN/99 KN. • Gjatësia mbyllur 50-55 cm. • Goditja e pistonit (faza 1/2) 5-10 ton. • Forca tërheqëse 2.5-3 ton. <p>Gjenerator hidraulik:</p> <ul style="list-style-type: none"> • I paisur me 2 lidhëse (CORE) tuba në trup.

			<ul style="list-style-type: none"> • Maksimumi i presionit në punë 700-720bar. • Pesha 25-35 kg. • Numri i lidhjeve 2. • Numri i mjeteve njëkohësisht në përdorim 2. • Motorr me 4 kohë. <p>Pajisja duhet te jete e re.</p>
7.	Përzjerës shkume Ø52		<p>Rezistente ndaj kimikateve, flakëve dhe motit. Presioni i testimit 25 bar, presioni i shpërthimit 50 bar.</p> <p>Hyrja me presion : Ø52 mm, Hyrja e thithjes: Ø25 mm, Rrjedha : 400 l, Dimensionet: 360x175x165, Pesha : 3,4 kg</p>
8.	Disk i madh		<p>Disk i madh për prerjen e betonit dhe hekurit me ushqim elektrik.</p> <p>Fuqia 4.1 HP - 3.0 kW</p> <ul style="list-style-type: none"> • Diametri i diskut prerës 350 mm • Maks. thellësia e prerjes 120 mm

<p>9.</p>	<p>Aparate hermetik AP3 (aparat frymemarrje per punonjesit zjarrefikes)</p>		<p>Me bombël shpine 6 litra/presion 300 bar</p> <p>Maskë fytyre:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Silikon ose gomë. • Regjistrim sipas fytyrës. • Pamje të qartë natyrale. • Të mbulojë të gjithë fytyrën. <p>Aparati bazë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pllakë me rregullim të gjatësisë. • Me regjistrim sipas përmasave të personit. • Mbështetje anatomike e shpinës, me rripa me material zjarrdurues • Me 1 bombël. <p>Njësia e kontrollit të ajrit:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Me sinjal zanor paralajmërimi për nivelin e ajrit.
<p>10.</p>	<p>Reduktues 70-50</p>		<p>Reduktues seksioni 70-50 bar</p> <p>Pajisje kapëse, seksion qendror i derdhur në aliazh alumini AK 11 (Guarnicione gome</p> <p>Kunj mbyllëse çeliku i galvanizuar</p>
<p>11.</p>	<p>Radio-ndërlidhje</p>		<p>Aparate radio me 14 radio dore me perimetër deri në 3 km.</p>
<p>12.</p>	<p>Ezhekor thithës</p>		<p>Rezistente ndaj kimikateve, flakëve dhe motit. Thithje me tub Ø52 mm dhe dalje Ø70 mm.</p>

13.	Ventilator tymi		<p>Me lëndë djegëse benzin/naftë për pastrimin e ajrit në objekte, Pesha 55 lbs / 25 kg Dimensionet 19 x 18 x 16 in (h/w/d) 48 x 46 x 31 cm Përforcuesit: Nisja 115 V: 80A 230V: 40A Funksionimi 115V: 15A 230V: 8A Motori 1.5 Hp / 1.1 kW Zhurma 90,2 dB @ 3' (1 m) Elektrike 115/230V, 1ø, 50/60Hz</p>
14.	Shkallë alumini me 4 elementë		<ul style="list-style-type: none"> • Hapja dhe mbyllja e tyre bëhet me litar, zinxhirë dhe kablllos së montuar në këmbën e poshtme dhe të sipërme të pjesës së dytë. • Kur tërhiqet zixhiri, pjesa e dytë dhe e tretë e shkallës, në këtë rast lëviz dy herë më shpejtë se pjesa e dytë. • Në anën e poshtme të pjesës së dytë është montuar boshti i mekanizmit që bën të mundur ndalimin e shkallës në çfarëdo lartësie, në këtë rast gjuhëza e boshtit mbështetet në këmbët përkatëse të boshtit. • Gjatësia është 13.5 m, gjerësia është 58 cm, në pjesën e poshtme, në atë të sipërme është 45 cm dhe pesha 100 kg.
15.	Pompa shpinore për makinat e zjarrit		<p>Pompa Shpinore me material të lartë termik, 20 litra uji, permasa 64 x 50 x 5 cm, materiali 100% Polyester H.T. 1.110 dtex + PVC, gjatesia e tubit m</p>

Njesia e Prokurimit
